

MENDIM PARALEL

Unë, Genta Tafa (Bungo), në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, që ka kryer procesin e rivlerësimit të subjektit Periand Teta, kam votuar pro konfirmimit të tij, por duke kërkuar gjithashtu emërimin e tij në përputhje me shkronjën “a” të nenit 58/2 të ligjit nr. 84/2016.

Më konkretisht, parashtroj si më poshtë vijon:

1. Me vendimin nr. 657, datë 28.4.2023, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për subjektin e rivlerësimit.

2. Ky vendim i Komisionit është prishur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin nr. 35, datë 17.7.2024, nëpërmjet të cilit Kolegji ka urdhëruar Komisionin që të vijojë procesin e rivlerësimit të subjektit Periand Teta.

3. Në pikën 10.10 të këtij vendimi, fjalia e fundit, Kolegji shprehet tekstualisht: *“Megjithëse nuk është më në detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor, ai duhet të rivlerësohet si ish-ndihmës/ish-këshilltar ligjor me kërkesë, pasi, siç pranohet edhe nga Komisionerja Publike, pezullimi nga detyra nuk e cenoi kriterin trevjeçar të vjetërsisë në këtë funksion.”*

4. Në pikën 12, fjalia e fundit e po këtij vendimi, Kolegji shprehet: *“Komisioni të urdhërohet të kryejë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit **si ish-këshilltar ligjor.**”*

5. Për sa më sipër, rezulton se Kolegji ka urdhëruar Komisionin që subjekti i rivlerësimit të rivlerësohet **si ish-ndihmës/këshilltar ligjor.**

6. Në lidhje me procesin e rivlerësimit për ish-ndihmësit/këshilltarët ligjorë, gjejnë zbatim dispozitat e mëposhtme kushtetuese dhe ligjore:

i. Në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: *“Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, do të rivlerësohen ex officio. **Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.**”*

ii. Në nenin 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *“2. Në rast se subjektet e rivlerësimit, **sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës, kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, Komisioni mund të vendosë: a) emërimin si gjyqtar ose prokuror; në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve; b) refuzimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror; në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.**”*

7. Në përfundim të procesit të rivlerësimit për këtë subjekt, konstatohet se:

- a) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

8. Në këto kushte, vlerësoj se subjekti ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, pra ai ka plotësuar në mënyrë kumulative të tria kushtet e parashikuara nga neni 59/1 i ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, në vijim të vendimmarrjes, Komisioni duhet të bazohet në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 58.

9. Ky qëndrim mbështetet edhe në faktin se subjekti i rivlerësimit nuk kryen aktualisht detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, pasi marrëdhëniet e tij të punës janë ndërprerë që në vitin 2017 nga ana e kësaj Gjykate.

10. Duke marrë në konsideratë faktin se:

- a. *subjekti është liruar nga detyra e ndihmësit ligjor në datën 25.7.2017, me urdhrin nr. *** të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ai nuk gëzon aktualisht statusin e këshilltarit ligjor pranë kësaj Gjykate;*
- b. *subjekti është në një proces gjyqësor në lidhje me këtë marrëdhënie pune të ndërprerë nga Gjykata e Lartë, pasi nga aktet e administruara rezulton se padia e subjektit është rrëzuar me vendimin nr. ***, datë 21.2.2018, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ky vendim është ankimuar dhe është në pritje për shqyrtim nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm,*

- mendoj se konfirmimi në detyrën e këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë të subjektit nga ana e Komisionit (detyrë nga e cila është liruar që në vitin 2017 dhe është në proces gjyqësor të papërfunduar me një vendim të formës së prerë), duket se ka zgjidhur mosmarrëveshjen civile që subjekti ka pasur me Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë baza ligjore mbi të cilën është marrë vendimi i Komisionit bie ndesh me parashikimet e nenit 36/3 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.”*

11. Në vijim të argumentimit të mësipërm, për sa kohë subjekti është liruar nga detyra e këshilltarit ligjor dhe kjo mosmarrëveshje është objekt gjykimi në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, vlerësoj se ekzekutimi i vendimit të Komisionit mund të bëhet i pamundur, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtat e subjektit, që rrjedhin nga procesi i rivlerësimit, të cilin ai e ka kaluar me sukses.

12. Nga ana tjetër, vlerësoj se koncepti i konfirmimit në detyrë ka të bëjë me vijueshmërinë e një detyre, nëse plotëson në mënyrë kumulative kriteret e rivlerësimit. Në rastin konkret, subjekti nuk e ushtron këtë detyrë prej kohësh dhe, për më tepër, ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me kërkesën e tij, si ish-këshilltar ligjor. Për pasojë, procesi i tij i rivlerësimit, i kaluar me sukses, do të duhej të çonte automatikisht në aplikimin e nenit 58/2 të ligjit nr. 84/2016.

13. Për sa më sipër, çmoj se Komisioni, në zbatim të urdhërimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, do të duhej të kryente procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit si ish-këshilltar ligjor dhe në përfundim të këtij procesi të zbatonte dispozitat e nenit 58/2 të ligjit nr. 84/2016.

Genta TAFA (BUNGO)
Komisionere